



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____.2023

VENDIM

Nr.363, datë 13.07.2023

PËR

**RENDITJEN E KANDIDATËVE NË PROCEDURËN E NGRITJES
NË DETYRË NË GJYKATËN E POSAÇME TË SHKALLËS SË PARË PËR
KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR, PËR POZICIONIN
E LIRË TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 128, DATË 01.04.2021,
TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 13.07.2023, pasi u njoh me materialet e çështjes, me projektvendimin “Për renditjen e kandidatëve në Procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 128, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, si dhe me Relacionin përkatës mbi këtë projektvendim, për gatitur nga relatori i procedurës së përzgjedhjes z. Alban Toro,

VËREN:

I. TË DHËNA MBI PROCEDURËN E PËRZGJEDHJES

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim referuar si Këshilli) pas plotësimit të kuadrit ligjor nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore të autorizuara nga ligji¹, në ushtrim të përgjegjësisë për mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor (neni 147, pika 1, i Kushtetutës) dhe në veçanti të

¹ Vendimi nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”;
Vendimi nr. 263, datë 21.11.2019, “Për rregullat plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”;
Vendimi nr.264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”;
Vendimi nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”.

funksionit të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve të të gjitha niveleve (neni 147/a, pika 1, shkronja “a”, i Kushtetutës), në kuadër të plotësimit të pozicionet e lira në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ka hapur procedurat e ngritjes në detyrë, ndër të tjera, edhe për një pozicion të lirë, me Vendimin nr. 128, datë 01.04.2021.

2. Pas përfundimit të afatit të kandidimit në procedurën e ngritjes në detyrë për pozicionin e parë të lirë të hapur me Vendimin e Këshillit nr. 128, datë 01.04.2021, pra deri më datë 16.04.2021, aplikoi një kandidat, konkretisht znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë aktualisht gjyqtare e skemës së delegimit e caktuar për një periudhë kohe në Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

3. Sipas pikës 9, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (më poshtë referuar si Ligji për Statusin), në një procedurë ngritjeje në detyrë për një pozicion të lirë, Këshilli i Lartë Gjyqësor bën renditjen e kandidatëve *që përmbushin kriteret*, renditje kjo që bëhet në funksion të përzgjedhjes së kandidatit të renditur më lart, i cili do të duhet të ngrihet në detyrë në atë pozicion të lirë.

4. Për të evidentuar kandidatët që përmbushnin kriteret e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Këshilli realizoi procedurat e verifikimit të plotësimit nga në rastin konkret për të vetmin kandidat të kriterëve të më poshtme:

- 1) **“përvojës profesionale minimale”**, sipas shkronjës “b”, pika 2, të nenit 47, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“2. Magjistrati ngrihet në detyrë nëse plotëson këto kriteret minimale për përvojën profesionale: ...; b) Për pozicionin gjyqtar në gjykatën e posaçme të shkallës së parë për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar, magjistrati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet si gjyqtar, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar në fushën e drejtësisë kriminale ose si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”;*
- 2) **“mospasjes masë disiplinore në fuqi”**, sipas pikës 8, të nenit 48, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“8. Vetëm kandidatët të cilët ... nuk kanë masa disiplinore në fuqi, pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”;*
- 3) **“mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”**, sipas nenit 8, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“1. Papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magjistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë. 2. Këshillat, gjatë ... ngritjes në detyrë të magjistratit, për aq sa është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë joproporcionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magjistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni, me*

qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magjistratit, eficienta e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë. 3. Papajtueshmëri ambientale përbëjnë rrethanat e mëposhtme: a) nëse respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori ku magjistrati kërkon të caktohet, ushtron funksionin një magjistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni; ... 5. Për efekt të zbatimit të kësaj dispozite, magjistrati, në momentin e paraqitjes së kërkesës për ... ngritje në detyrë, paraqet një vetëdeklarim përpara Këshillit, ku deklaron nëse ndodhet apo jo në një nga rastet e papajtueshmërisë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni. ...”;

- 4) **“dhënies së pëlqimit (ai dhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”,** sipas pikës 4, të nenit 135, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku përcaktohet se: *“4. ... Kandidatët për gjyqtarë ... në gjykatat e posaçme, si dhe familjarët e afërm të kandidatëve, para emërimit, ..., si dhe japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit”*; pikës 3, të nenit 47, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“3. Për të gjitha pozicionet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, magjistrati duhet të përmbushë edhe kriteret e tjera dhe kushtet e sigurisë, të parashikuara në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”*; si dhe pikave 1 dhe 2, të nenit 48, të Ligjit nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, ku përcaktohet se: *“1. Përpara emërimit, kandidatët për gjyqtarë ... në gjykatat kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar ... firmosin deklaratën përkatëse me shkrim për heqjen dorë nga e drejta e tyre për pritshmëri për privatësi (jetë private) në telekomunikimet e tyre dhe në të dhënat financiare, të dhënë në shtojcat B1 e B2 të këtij ligji. Kjo deklaratë firmoset përpara se ata të caktohen me detyrë apo të punësohen. 2. Anëtarët e afërt të familjeve të personave të përmendur në pikën 1 gjithashtu firmosin deklaratën përkatëse për heqjen dorë nga të drejtat, të dhënë në shtojcën B3 të këtij ligji, si tregues se i kuptojnë kushtet”*;
- 5) **të pasurisë dhe figurës,** sipas pikave 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“7. Këshilli verifikon kandidatët, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji”,* si dhe: *“8. Vetëm kandidatët të cilët kalojnë verifikimin e pasurisë dhe figurës ..., pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”*.

5. Kështu, për kandidaten e vetme, znj. {...}, Këshilli verifikoi plotësimin nga ajo të kriterëve të kandidimit dhe me Vendimin nr. 234, datë 30.06.2022, vendosi kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurave përkatëse për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë ku ka kandiduar.

6. Ndërkohë, krahas procedurës së verifikimit të kritereve të kandidimit, paralelisht, për kandidaten kanë vijuar edhe procedurat e vlerësimit etik dhe profesional, konkretisht: 1) vlerësimi me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016 (periudhën e rivlerësimit kalimtar), referuar pikës 5, të nenit 171, të Ligjit për Statusin; 2) si dhe vlerësimi për periudhën 2017-2019 bazuar në Vendimin e Këshillit nr. 177 datë 29.04.2021 “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik profesional për periudhën e vlerësimit 2017-2019, për gjyqtaret pjesë e programit të vlerësimeve për vitin 2021”.

7. Me kualifikimin e kandidates znj. {...}, bazuar në pikën 24, të Vendimit të Këshillit nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve” (më poshtë referuar si Vendimi 70/2020), Këshilli, me Vendimin nr. 261, datë 15.07.2022, filloi procedurën e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, edhe për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e tij nr. 128, datë 01.04.2021. Me këtë vendim, si relator i procedurës së përzgjedhjes u caktua anëtari i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, z. Alban Toro.

8. Më datë 15.07.2022, në rrugë elektronike, në zbatim të pikës 30, të Vendimit 70/2020, kandidatja e kualifikuar u njoftua për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për pozicionin e lirë ku ajo kandidonte, si dhe për caktimin e relatorit. Kandidatja nuk paraqiti kundërshtime ose kërkesë për përjashtimin e relatorit apo për ndonjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit.

9. Në zbatim të shkronjës “a”, pika 47, të Vendimit 70/2020, relatori administroi dokumentacionin përkatës të kandidates, që gjendej në dosjen e saj personale apo në praktikën dokumentare të procedurës së verifikimit të plotësimit të kritereve të kandidimit. Po ashtu, relatori administroi edhe vendimet përkatëse të Këshillit në lidhje me vlerësimet etike dhe profesionale për të.

10. Konkretisht, lidhur me vlerësimet etike dhe profesionale, për kandidaten e vetme znj. {...} u konstatua se:

- a) Sipas Vendimit të Këshillit nr. 120, datë 15.03.2023, kandidatja është vlerësuar për periudhën 2017-2019, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”, duke grumbulluar në total 390 pikë, sipas “Raportit të vlerësimit etik dhe profesional” të miratuar me këtë vendim.
- b) Sipas Vendimit nr. 43, datë 27.01.2023 Këshilli ka vendosur për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarës {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016.

11. Dy vendimet e sipërcituara të Këshillit të Lartë Gjyqësor të kandidates znj. {...} të miratuara me Vendimet e Këshillit nr. 43, datë 27.01.2023 dhe nr. 120, datë 15.03.2023, u konstatuan të jenë bërë përfundimtarë, ndërsa ndaj tyre nuk rezulton të jetë paraqitur ankim.

12. Në kushtet kur pas kryerjes së procedurës së verifikimit të kriterëve të kandidimit, për kandidaten do të duhej të vijonin edhe procedurat e vlerësimit etik dhe profesional, konkretisht: 1) vlerësimi me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016 (periudhën e rivlerësimit kalimtar), referuar pikës 5, të nenit 171, të Ligjit për Statusin; 2) vlerësimi i përshpejtuar për vitin 2019, referuar pikës 3, të nenit 25, “Dispozitë kalimtare”, shtuar në këtë ligj me Ligjin nr.48/2019, relatori me datë 27.06.2023, bazuar në nenin 48 nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar iu drejtua Komisionit të Vlerësimit Etikë Profesional për të kërkuar informacione në lidhje me ecurinë e përfundimit të vlerësimeve të mundshme.

12.1 Nga Komisioni i sipërcituar raportohet ndër të tjera se “ *...Omissis. Gjyqtarja është emëruar ne detyre ne dt. 21.10.2013. Lidhur me vlerësimet e kryera dhe mundësinë e kryerjes se vlerësimeve te tjera deri ne momentin kur gjyqtarja ka kandiduar për ngritje ne detyre, ju informoj se : Gradimi i gjyqtarës ka qene i pamundur ne objekt e qellim për tu realizuar, sepse ne periudhën e vlerësimit 2013-2016, gjyqtarja ka pasur me pak se 1/vit kohe efektive pune për tu vlerësuar, prandaj Këshilli me vendimin nr.43 dt. 27.01.2023 ka vendosur për këtë periudhe përfundimin pa vendim përfundimtar te procedurës se vlerësimet etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2013-2016. Gjyqtarja është përfshire ne programin e vlerësimeve për vitin 2021, duke u vlerësuar ne nivelin "shkëlqyeshëm" për periudhën e vlerësimit 2017-2019 (vendimi Nr. 120/2023). Deri ne momentin e kandidimit, qe është data 01.04.2021, periudha e vetme qe mbetet për tu vlerësuar është ajo e vitit kalendarik 2020, por vlerësimi vetëm për këtë vit nuk mund te filloje sepse :*

- Vlerësimet normale periodike qe Këshilli mund te zhvilloje janë 3 ose 5/vjeçare, ne varësi te periudhës profesionale te gjyqtarit, nen ose mbi 15/vjet. Ne kushtet kur gjyqtarja nuk ka plotësuar ende 10/vjet përvojë profesionale, pas vlerësimit te vitit 2017-2019, si rregull vlerësimi tjetër periodik i saj duhet te përkohet me periudhën 2020-2022, dhe si i tille ky vlerësim nuk mund te përdoret për kandidime për ngritje ne detyre qe i përkasin vitit 2021.

-Përjashtim nga rregulli i mësipërm mbi periodicitetin e vlerësimeve, Këshilli ne zbatim te nenit 97 te Ligjit për Statusin dhe akteve qe plotësojnë skemën e vlerësimit te gjyqtarëve, fillon për te gjithë gjyqtaret qe kandidojnë për ngritje ne detyre ose lëvizje paralele, vlerësim te përshpejtuar te detyruar për vitin e fundit kalendarik, vetëm ne rast se kane kaluar 2/vjet nga vlerësimi i fundit. Duke konsideruar datën e kandidimit te gjyqtarës, qe është data 01.04.2021, vlerësim i përshpejtuar për te, nëse do te fillonte një i tille, përkon me periudhën e vlerësimit qe përfshin vitin kalendarik 2020. Por ne këtë rast nuk kane kaluar 2/vjet nga vlerësimi i fundit i gjyqtarës, sepse ajo është vlerësuar për periudhën e vlerësimit 2017-2019 dhe viti 2020 është viti kalendarik pasardhës vitit 2019. Pra për këtë gjyqtare, duke konsideruar datën e kandidimit te saj për ngritje ne detyre dt. 01.04.2021, nuk mund te filloje një vlerësim tjetër i përshpejtuar për vitin 2020, prandaj dhe KVEVP nuk ka sjelle ne plenare një propozim te tille.

Si përfundim KVEVP vlerëson se për gjyqtaren {...} nuk mund te kryhet vlerësim i përshpejtuar për vitin 2020, por ky vit duhet te konsiderohet ne periudhën e mëpasshme te vlerësimit 3/vjeçare 2020-2022...”.

12.2 Përfundimisht përpara relatorit shtrohet për zgjidhje çështja : *Nëse në përputhje me pikën 9, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (më poshtë referuar si Ligji për Statusin), në një procedurë ngritjeje në detyrë për një pozicion të lirë, a mund të bëhet renditja e kandidatit që përmbushin kriteret kualifikuese por disponon vetëm një vlerësim, (atë për periudhën e vlerësimit 2017-2019) ?.*

13. Në interpretim të dispozitës ligjore parashikuar nga neni 48 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” Procedura e ngritjes në detyrë bazohet në parimet e transparencës, barazisë, aftësisë dhe përvojës profesionale. Fillimisht kandidati do të duhet të plotësojë kriteret ligjore mos disponimi i së cilave e s’kualifikon detyrimisht atë nga vijimi i mëtejshëm i procedurës. Siç janë cituar më lart kriteret me natyrë skualifikuese janë ato të parashikuara fillimisht ato në nenin 162, pika 7 të Ligjit për Statusin si edhe në neni 57, pika 11, i Ligjit nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të cilat kanë të bëjnë me procesin e *rivlerësimit*, sipas nenit 179/b, të Kushtetutës, dhe ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të funksionarëve të sistemit të drejtësisë në Republikën e Shqipërisë” si edhe në pikën 3 të nenit 8, në shkronjën “b” të pikës 2 dhe pikën 3 të nenit 47, si dhe në pikat 7 dhe 8 të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Ne mënyrë të përmbledhur dispozita përcakton se a) për pozicionin gjyqtar në gjykatën e posaçme të shkallës së parë për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar, magjistrati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet si gjyqtar, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar në fushën e drejtësisë kriminale ose si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar; b) Kandidati duhet të japë pëlqimin (ai edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”; c) Kandidati duhet të kalojë me sukses procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, sipas Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, (neni 48, pikat 7 dhe 8,) dhe Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”; ç) Kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi; d) Kandidati duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. ...omissis..”.

14. Me plotësimin e kriterëve të sipërcituara të natyrës s’kualifikuese, ligji qëllimi i të cilit është vendosja e standardeve për mënyrën e vlerësimit të kandidatëve për plotësimin e vendeve vakante përmes procedurës së ngritjes në detyrë duke u bazuar në parimin e barazisë, në meritën profesionale, të transparencës dhe objektivitetit në vlerësim, nuk ka vlerësuar krijimin e ndalimeve të tjera penguese në konkurrim.

14.1 Vlerësimi i kandidatit, në përputhje me kriteret cilësore (kualitativ) e sasiore konvertuar me vlerësimin maksimal apo pikët më të larta të përlllogaritura sipas pikës 9 dhe 14 të nenit 48 të Ligjit e identifikon atë si më të mirin në atë procedurë të përzgjedhjes dhe të përshtatshëm për

pozicionin e lirë. Në këtë kontekst kriteri i pasjes së dy vlerësimeve merr vlerë në një procedurë konkurrimi për të përzgjedhur më të mirin duke pasqyruar në këtë mënyrë efektin e saj plotësues/komplementar me qellim arritjen e një sistemi gjyqësore e një cilësie më të lartë të mundshëm. Duke iu kthyer çështjes “de qua” kryerja e vlerësimit etik dhe profesional për kandidatin në këtë rast, përveç se përbën një detyrim ligjor, të Këshillit të Lartë Gjyqësor ajo nuk duhet të rendojë mbi kandidatin në kushtet e mungesës së plotë të konkurrencës në atë pozicion të lirë.

15. Kalimi i procesit të rivlerësimit me sukses nga ana e saj referuar përcaktimit të shkronjës “c”, pika 1, të nenit 59, të Ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, prezumon se kandidati ka arritur një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, pra se ai është vlerësuar “I aftë”, pra që ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve ose viktimave, si dhe se ka qenë eficient dhe efektiv në masë të pranueshme përgjatë periudhës së rivlerësimit kalimtar, sikurse një gjë e tillë përcaktohet në shkronjën “a”, të nenit 44, të këtij ligji.

16. Vlerësimi në nivelin e përgjithshëm “i pamjaftueshëm”, pra një vlerësimit etik dhe profesional me cilësi të dobët, jo vetëm nuk do të përligjte ngritjen në detyrë, por, përkundrazi, referuar pikës 6, të nenit 95, të Ligjit për Statusin, do të përbënte shkas për dërgimin e raportit të vlerësimit Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për të vlerësuar fillimin e hetimit dhe, më tej, të procedimit disiplinor ndaj kandidatit, duke vënë kështu në diskutim nga ana tjetër, plotësimin e kriterëve të kandidimit prej tij dhe ndalimin në konkurrim.

17. Në Opinionin 17 (2014), CCJE^{ja}, pjesë të së cilës janë integruar edhe në legjislacionin tonë, ka mbështetur pikëpamjen se prania e një lloji vlerësimi është e nevojshme dhe se standardet objektive nuk kërkohen vetëm për të përjashtuar ndikimin politik, por edhe për të shmangur rrezikun e përshtypjes së mundshme se ka favorizim, e cila është e pranishme nëse emërimet/vlerësimet bëhen në mënyrë të pa strukturuar, ose mbështetur në rekomandimet. Këto standarde objektive duhet të mbështeten në merita, duke marrë parasysh kualifikimet, integritetin, aftësinë dhe eficientësinë dhe duke shqyrtuar të gjitha aspektet të përbëjnë performancë të mirë gjyqësore.

17.1 Disponimi i vlerësimit për periudhën 2017-2019, nivelin "shkëlqyeshëm", kalimi me sukses i procesit të rivlerësimit kalimtar, mungesa e konkurrimit në këtë pozicion të lirë e për rrjedhojë, edhe në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve është vetëm një i tillë, u vlerësua se nuk ka vend për ndjekjen e hapave, kriterëve dhe përparësive sipas përcaktimeve të Kreut IV, të Vendimit 70/2020, në funksion të renditjes së kandidatëve. Në këtë përfundim relatori ka arritur përmes vlerësimit të interpretimit që i bëhet tekstit të shkruar të normës, Ligjit nr.96/2016, (interpretim gramatikor), kontekstit të saj (interpretim sistematik), synimit të normës (interpretim teologjik).

18. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar, në kushtet kur në këtë procedurë ngritjeje në detyrë ka kandiduar vetëm një kandidat dhe, për rrjedhojë, edhe në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve është vetëm një i tillë, u vlerësua se nuk ka vend për ndjekjen e hapave, kriterëve dhe përparësive sipas përcaktimeve të Kreut IV, të Vendimit 70/2020, në funksion të renditjes së kandidatëve. Nga ana tjetër, në respektim të përcaktimeve të Seksionit B, Kreu VI, të Vendimit 70/2020, relatori përgatiti projektvendimin “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 128, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

II. SHQYRTIMI DHE VLERËSIMI I KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

19. Projektvendimi “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.128, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, si dhe materialet e administruara në kuadër të procedurës së përzgjedhjes, iu nënshtruan shqyrtimit nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas përcaktimeve të bëra në Seksionin Ç, Kreu VI, të Vendimit 70/2020.

20. Gjatë shqyrtimit, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerësoi si të plota veprimet procedurale dhe verifikuese të kryera nga relatori, ashtu sikundër edhe të dokumentacionit të administruar për kandidaten në funksion të renditjes, përveç edhe korrektësinë e projektvendimit.

III. KONKLUZIONI

21. Mbi sa më sipër, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerësoi se ishte rasti për miratimin e projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 128, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në nenet 135, 147 dhe 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 85, 86, 97 dhe 98, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në pikat 9, 10 dhe 14, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr.70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

V E N D O S I:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 128, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:
 - 1) Znj. {...}
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.
3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR